



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KOMERCIALE
DHOMAT E SHKALLËS SË DYTË

K.DH.SH.II.nr.276/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS - Dhomat e Shkalles se Dytë, gjyqtari Dren Rogova, ne çështjen juridike përmbartimore të kreditorit “Petrol Company” sh.p.k Zona Industriale Prishtinë –Fushë Kosovë, kundër debitorit: Miniera me Flotacion TREPÇA SH.A me seli në Mitrovicë, lidhur me pagesën e borxhit në bazë të dokumentit të besueshëm – faturës, në shumë prej 12,971.99 €, duke vendosur lidhur me ankesën e debitorit, e paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Mitrovicë - Departamenti i Përgjithshëm PPP.nr.1014/2021 të datës 28.02.2021, me datën 06.07.2023 mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET e pabazuar ankesa e debitorit Miniera me Flotacion TREPÇA SH.A me seli në Mitrovicë, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Themelore në Mitrovicë - Departamenti i Përgjithshëm PPP.nr.1014/2021 i datës 28.02.2021 VËRTETOHET.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Mitrovicë - Departamenti i Përgjithshëm me aktvendimin e atakuar PPP.nr.1014/2021 i datës 28.02.2021, e ka refuzuar në tersi si të pa bazuar prapësimin e debitorit Miniera me Flotacion TREPÇA SH.A me seli në Mitrovicë, të ushtruar kundër urdhrin mbi lejimin e përmbartimit P.nr.1149/2021 i dt. 21.07.2021, sipas propozimit të kreditorit “Petrol Company” sh.p.k Zona Industriale Prishtinë –Fushë Kosovë.

Kundër këtij aktvendimi, në afatin ligjor ka paraqitur ankesë debitori, për shkak të vërtetimit te gabuar de jo te plotë te gjendjes faktike me propozim qe gjykata e shkalles se dytë ta aprovoj këtë ankesë dhe ta anulojë aktvendimin e Gjykatës Themelore në Mitrovicë - Departamenti i Përgjithshëm PPP.nr.1014/2021 të datës 28.02.2021.

Dhomat e Shkalles se Dytë e Gjykatës Komerciale, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar, pretendimet ankimore dhe pas vlerësimit të tyre në kuptim të dispozitës së nenit 208 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK) e lidhur me nenin 17 të Ligjit për Procedurën Përmbartimore (LPP), gjeti se:

- Ankesa e debitorit është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori “Petrol Company” sh.p.k Zona Industriale Prishtinë – Fushë Kosovë ka ushtruar propozimin për përmbartim, me të cilin ka kërkuar që të lejohet përmbartimi ndaj debitorit “Trepça” Sh.A.-Mitrovicë, në bazë të dokumentit të besueshëm, fatura: nr.1876/21 dt.30.04.2021, Fatura: nr.1265/21 e dt.31.03.2021, Fatura: nr.669/2021 e dt.28.02.2021, Fatura nr.670/21 e dt.28.02.2021 si në shkresat e lëndës, me të cilën do të paguaj borxhin në shumë prej 12,971.99 euro, me kamatë prej 8% duke filluar nga data kur kërkesa është bërë e arritshme e deri në pagesën definitive të detyrimit, po ashtu edhe shpenzimet e procedurës përmbartimore të gjitha këto në afat (7) ditor nga dita e dorëzimit të propozimit për përmbartim, në të kundërtën të bëhet bllokimi i llogarive bankare, mjetet e mbledhura të transferohen në llogaria e debitorit në llogarinë e veçantë bankare të zyrës së përmbartuesit privat, të gjitha këto të specifikuar në propozimin për përmbartim të datës 21.07.2021.

Përmbartuesi privat me urdhrin përmbartimit P.nr.1149/21 i datës 21.07.2021, e ka lejuar propozimin për përmbartim në këtë çështje përmbartimore.

Debitori “Trepça” Sh.A.-Mitrovicë, brenda afatit ligjor ka ushtruar prapësim me shkrim kundër urdhrin përmbartimor, duke deklaruar se dokumentet, në bazë të të cilave është marr vendimi përmbartues ose urdhri përmbartues, nuk janë të përshtatshme për përmbartim. Dokumentet nuk janë të përshtatshme për përmbartim sepse në këto fatura nuk është cekur koha e përmbushjes së detyrimit ashtu siç parashihet në nenin 27 paragrafi 1 i Ligjit për Procedurën Përmbartimore në bazë të së cilës thuhet se “Dokumenti përmbartimor është i përshtatshëm për përmbartim në qoftë se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, mjetet, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit. Andaj duke pasur parasysh të lartcekurat i propozojnë Gjykatës Themelore në Mitrovicë që të anulojë urdhrin për përmbartim P.nr.1149/21 të datës 21.07.2021.

Pas prapësimit të ngritur nga debitori, kreditori ka paraqitur përgjigje në prapësim duke kundërshtuar pretendimet e debitorit se faturat nuk janë të përshtatshme për përmbartim sepse nuk është cek koha e përmbushjes së përmbartimit nuk qëndron pasi që faturat janë konform dispozitave të LPP-së, për me teper debitori të gjitha këto fatura i ka pranuar dhe protokolluar pa vërejtje dhe i njëjti është njoftuar dhe përmes emailit se ne raste të mos pagesës së obligimit lënda do të procedohet tek përmbartuesi. Kreditori në propozimin për përmbartim ka bere edhe precizimin e përmbartimit ku kemi kërkuara që të paguhet vetëm vlera e mbetur e obligimit në shumën prej 12,971.99.

Gjykata Themelore në Mitrovicë - Departamenti i Përgjithshëm pas vlerësimit të prapësimit dhe përgjigjes në prapësim, ka nxjerrë aktvendimin PPP.nr.1014/2021 të datës 28.02.2021, me të cilin e ka refuzuar në tersi si të pa bazuar prapësimin e debitorit Miniera me Flotacion TREPÇA SH.A me seli në Mitrovicë, të ushtruar kundër urdhrin mbi lejimin e përmbartimit P.nr.1149/2021 i dt. 21.07.2021, sipas propozimit të kreditorit “Petrol Company” sh.p.k Zona Industriale Prishtinë –Fushë Kosovë.

Me rastin e vendosjes, gjykata e shkallës së parë ka vlerësuar se kreditori ka plotësuar të gjitha kushtet sipas faturës ndaj debitorit, pasi që ne çdo faturë figuron data e pagesës së obligimit nga ana e debitorit, po ashtu në bazë të e-mailave që figurojnë në shkresat e lëndës të cilat janë

dërguara debitorit me dt.13.07.2021 dhe dt.15.07.2021 i njëjti ka qenë i njoftuar për obligimin që ka ndaj debitorit për përmbushjen e borxhit në fjalë në të kundërtën do të vazhdohet me procedura tjera ligjore.

Nisur nga kjo gjendje e çështjes, Gjykata Komerciale – Dhoma e shkallës së dytë, vlerëson se gjykata e shkallës së parë i ka zbatuar drejtë dispozitat e Ligjit të Procedurës Përmbartimore kur e ka refuzuar prapësimin e debitorit të paraqitur kundër urdhrin të përmbartuesit privat, ngase edhe sipas vlerësimit të kësaj gjykate me shikimin në shkresat e lëndës qartë konstatohet se përmbartimi është lejuar në bazë të faturave të lartcekura të cilat janë të pranuar nga debitori dhe se të njëjtat janë në origjinal, të pranuar dhe të nënshkruar nga debitori. Këto fatura e kanë cilësinë e dokumentit të besueshëm konform nenit 29 paragrafi 1 pika 1.3 të LPP-së dhe si të tilla paraqesin bazë juridike për caktimin e përmbartimit.

Faturat që janë bazë për lejimin e përmbartimit i përmbajnë elementet siç kërkohet me paragrafin 3 të këtij neni, i cili përcakton se: *“Dokumentit i besueshëm është i përshatshëm për përmbartim po që se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, shuma dhe koha e përmbartjes së detyrimit monetar”* si dhe është në pajtim me nenin 37 të LPP-së i cili thotë se *“kur propozimi për përmbartim paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit të bashkëngjitet dokumenti i tillë në origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit”*.

Prandaj, bazuar në këto arsye, Gjykata e shkallës së dytë vlerëson se gjykata e shkallës së parë në bazë të provave të cilat i ka pasur në dispozicion në shkresat e lëndës, ka dhënë aktvendimin e saj të bazuar në dispozita konkrete ligjore, ashtu që përfundimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, lidhur me këtë çështje e pranon edhe Gjykata e shkallës së dytë.

Sipas vlerësimit të kësaj gjykate, pretendim i vetëm ankimor i debitorit me ankesë është mungesa e përmbartjes origjinale të dokumentit të besueshëm apo kopjes së vërtetuar konform Nenit 40 par. 1 pika 1.3 të LPP-së. Andaj, kjo Gjykatë rithekson se faturat janë të vullosura në origjinal nga të dyja palët dhe nuk ka të meta sa i përket origjinalitetit të faturës, andaj duke u kufizuar në pretendimet ankimore të debitorit kjo gjykatë vlerëson se të njëjtat janë të pabazuara

Sipas kësaj gjykate, aktvendimi i atakuar është i rregullt dhe i ligjshëm, për arsye se i njëjti nuk është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2 pika (b), (g), (j) (k) dhe (m) të LPK dhe në konstatim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike e të cilat shkaqe ankimore gjykata e shkallës së dytë i vlerëson edhe sipas detyrës zyrtare, në bazë të nenit 194 të LPK-së.

Nga të gjitha arsyet e paraqitura e në pajtim me dispozitat e nenit 209 paragrafi 1 pika (b) të LPK lidhur me nenin 17 të LPP, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS,
Dhomat e Shkallës së Dytë
K.DH.SH.II nr.276/23, me datë 06.07.2023

Gjyqtari,
Dren Rogova